

Albjona Ocelli ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, në degën Inxhinieri Informatike dhe Matematikë, si dhe ka vijuar studimet pasuniversitare duke u diplomuar me Master Shkencor në të njëjtën fushë.

Me një përvojë të konsoliduar në administratën publike, aktualisht mban pozicion drejtues në Drejtorinë e Projekteve Inovative pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ku angazhohet në hartimin dhe zbatimin e iniciativave inovative me ndikim në zhvillimin ekonomik, modernizimin e shërbimeve publike dhe promovimin e teknologjive të avancuara.

Në pozicione të mëparshme, ka ushtruar detyrën e Përgjegjëses së Sektorit në Drejtorinë e Transformimit Digjital, ku ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe proceseve të digjitalizimit në administratën shtetërore.

Me një eksperiencë mbi 10-vjeçare në Ministrinë e Kulturës, ka kontribuar në role të ndryshme, përfshirë atë të Ekspertes IT, si dhe në administrimin e aseteve dhe shërbimeve, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe koordinimin e delegacioneve ndërkombëtare.

Gjithashtu, ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e inovacionit, teknologjisë së informacionit dhe administratës publike.